



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE DHE INVESTIMEVE**

Nr. _____ Prot.

Elbasan, më ____ . ____ . 2026

LËNDA: Dërgim njoftimi i fituesit për botim në Buletinin e Njoftimeve Publike.

AGJENCISË së PROKURIMIT PUBLIK

T I R A N Ë

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT

Nga: **Bashkia Elbasan** adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan

Drejtuar: **OE “Nova Motor Solutions” sh.p.k. me nipt M51901012F**, me adrese: Tirane

Vaqarr, Magazine 1 kateshe, mbas kështjellës Konti, Zona Kadastrale 3712

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) X

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** **X**

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO X**

Tipi i Kontratës: Mallra

Lloji i Procedurës së prokurimit: Procedurë e Hapur e thjeshtuar

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-93520-07-15-2026

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: 05.08.2026

Data e Publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit *data 10.08.2026, Buletini Nr.51*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje automjeti 4x4 pickup për Drejtorinë e Mbrojtjes Civile dhe SHMZSH-në”, me fond limit 4,166,666 (katërmilion njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh , vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Elbasan për vitin 2026.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto ☐

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **X**

Me anë të këtij Formulari bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse, si më poshtë:

1. “Nova Motor Solutions” sh.p.k., me Nipt: M51901012F

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **4,100,000** (katërmilion e njëqindmijë) **lekë pa tvsh.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO **X**

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. “O&A” sh.p.k., me Nipt: M12218017P

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **3,999,000** (tremilion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntëmijë) **lekë pa tvsh.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO **X**

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. "BENNETT" sh.p.k., me Nipt: M11707049K

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **4,160,000** (katërmilion e njëqind e gjashtëdhjetëmijë) **lekë pa tvsh.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve, Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga pjesëmarrësit janë s'kualifikuar operatorët e mëposhtme:

1. "O&A" sh.p.k., me Nipt: M12218017P

Ne permbushje të kërkesës të parashikuar në piken 2.3.2 të kapacitetit teknik, të kriterëve të veçanta për kualifikim, ju kemi paraqitur katalog në gjuhë të huaj dhe jo në gjuhën e specifikuar në njoftimin e kontratës **që është gjuha shqipe**, cka bie në kundërshtim me parashikimet e pikës 2 të nenit 24 të VKM nr.285, dt.19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, dhe dokumentave të tenderit ku thuhet shprehimisht:

Në piken 2 të nenit 24 të VKM nr.285, dt.19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, parashikohet se:

Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe.

Në dokumentat standarte të tenderit - Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë germa B. PËRGATITJA E OFERTAVE. Pika 2 Gjuha e Ofertës, përcaktohet shprehimisht:

Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës.

Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e paraqitura në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në gjuhën shqipe.

Sa më sipër, oferta juaj refuzohet.

Në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Në VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, neni 82 parashikohet se: Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

2. “BENNETT” sh.p.k., me Nipt: M11707049K2

Ne permbushje te kerkeses te parashikuar ne piken 2.3.2 te kapacitetit teknik, te kriterave te vecanta per kualifikim, ju keni paraqitur katalog ne gjuhe te huaj dhe jo ne gjuhen e specifikuar ne njoftimin e kontrates **qe eshte gjuha shqipe**, cka bie ne kundërshtim me parashikimet e pikes 2 te nenit 24 te VKM nr.285, dt.19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, dhe dokumentave te tenderit ku thuhet shprehimisht:

Ne piken 2 te nenit 24 te VKM nr.285, dt.19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe.

Ne dokumentat standarte te tenderit - Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë germa B. PËRGATITJA E OFERTAVE. Pika 2 Gjuha e Ofertës, përcaktohet shprehimisht:

Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës.

Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e paraqitura në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në gjuhën shqipe

Sa më sipër, oferta juaj refuzohet.

Në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 82 parashikohet se: Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **“Nova Motor Solutions” sh.p.k. me nipt M 51901012 F**, me adrese: Tirane Vaqarr, Magazine 1 kateshe, mbas kështjellës Konti, Zona Kadastrale 3712, se oferta e paraqitur me vleren prej **4,100,000** (katërmilion e njëqindmijë) **lekë pa t.v.sh.**, është identifikuar si oferta fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkisë Elbasan**, Drejtoria e Prokurimeve Publike, rruga "Qemal Stafa", sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nese nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t'ju konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO ☐ JO ☒

Nëse Po (Nr. i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik)

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ
ZV.KRYETARI
Asim Sula